



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM RAJONAL
2020-2030

Prishtinë, 2020

1. Përmbajtja	
2. LISTA E SHKURTESAVE	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. HYRJE	5
2.1. Ligjet Aktuale	6
3. METODOLOGJIA	9
4. Analiza e gjendjes aktuale dhe sfidat kryesore:.....	10
4.1. Përshkrimi i gjendjes aktuale	10
4.3.1. Rajoni zhvillimor Qendër	13
4.3.2 Rajoni zhvillimor lindje	16
4.3.3 Rajoni zhvillimor perëndim	19
4.3.4 Rajoni zhvillimor jug	22
4.5 Praktikrat e Vendeve të Rajonit	28
4.6 Zhvillimi i politikave përmes adresimit të problemit	31
4.7 Struktura dhe objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal	32
4.8 Sfidat strategjike.....	32
4.9. Swot analiza.....	33
5. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	37
5.1. Vizioni	37
5.2. Objektivat Strategjike	37
5.3. Treguesit e performancës	40
6. INTERVENIMET KRYESORE TË STRATEGJISË	42
7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	42
7.1 Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë	42
7.1.1. Përgjegjësitë dhe Detyrat	43
8. NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	44
8.1 Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve	44
8.2 Vlerësimi i kostos sipas objektivave strategjike dhe specifike.....	44
8.3 Burimet e financimit të Strategjisë	44
9. PLANI I VEPRIMIT	45

2. LISTA E SHKURTESAVE

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal;
ZKM-ZPS	Zyra e Kryeministrit - Zyra për Planifikim Strategjik;
ZKIE/ZKM	Zyra e Kryeministrit për Integrim Evropian;
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal;
MF	Ministria e Financave;
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambijentit;
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
MI	Ministria e Infrastrukturës;
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës;
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës;
KK	Kuvendi Komunal;
SKQ	Sekretariati Koordinues i Qeverisë;
PQ	Programi i Qeverisë;
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë;
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve;
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim;
IP	Investime Publike;
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit;
SVL	Strategjinë Kombëtare për Zhvillim;
SKZH - PKRE	Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike;
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Zhvillim Rajonal për periudhën 2020-2030 është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të politikës së qeverisë për arritjen e një zhvillimi të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të rajoneve të vendit dhe për tejkalimin e dallimeve / pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të politikës evropiane të kohezionit dhe arritjes së rritjes të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030 përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjata të politikës së zhvillimit rajonal dhe mundëson koordinimin e politikave tjera sektoriale për zhvillim socio - ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë. Në këtë kuptim, kjo Strategji përmban objektiva të përcaktuara qartë, parasheh realizimin e veprimeve dhe funksionimin e mekanizmave, që mundësojnë arritjen e këtyre prioritetëve strategjike të fushës së zhvillimit rajonal dhe koordinimin ndër-institucional.

Strategjia parashihet ti kete tri objektiva strategjike si në vijim:

- Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave të zhvillimit rajonal

Në mungesë të kornizës ligjore për zhvillim rajonal në Kosovë, një ndër objektivat e dokumentit strategjik është hartimi, koordinimi dhe miratimi i politikave për zhvillim rajonal të balancuar. Në vitin e parë të zbatimit të kësaj Strategjie, do të realizohen veprimet dhe procedurat e nevojshme për hartimin e legjislacionit për zhvillim rajonal të balancuar, në koordinim dhe bashkëpunim me të gjitha institucionet përkatëse dhe akterët tjerë. Me politikën në fjalë, do të definohen fushat e zhvillimit rajonal, definimin e nevojave për investime, koordinimin e investimeve, punën dhe funksionimin e mekanizmave që do të merre

n me planifikim dhe implementim të programeve, etj.

- Objektivi Strategjik: 2. Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;

Zhvillimi rajonal i balancuar, nënkuptohet si një proces i uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio - ekonomik dhe ngritjes së cilësisë së jetës në rajone zhvillimore. Zhvillimi rajonal i balancuar nuk mund të arrihet pa ngritjen e kapaciteteve të rajoneve në mënyre që të kenë një konkurrencë të mirëfilltë ndër rajonale. Është e nevojshme të ndërmerren masa për të ngritur konkurrencën ndër rajonale në mënyrë që të arrihen nivele më të larta të produktivitetit, punësimit dhe prosperitetit.

Konkurrueshmëria rajonale është aftësia e një rajoni për të ofruar një ambient tërheqës dhe të qëndrueshëm për firmat dhe banorët për të jetuar dhe punuar¹

- Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;

¹ https://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/work/201701_regional_competitiveness2016.pdf faqe 2

Shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe ekonomike , është një prej themeleve që luan një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal. Promovimi i diversitetit kulturor, resurseve natyrore dhe kapaciteteve njerëzore në funksion të zhvillimit ekonomik rajonal është i nevojshëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Strategjia për Zhvillim Rajonal paraqet edhe argumentim të qartë të objektivave përmes treguesve, kjo strategji fokusohet në zvogëlimin e pabarazive rajonale bazuar në praktikën e rajonit dhe më gjerë duke qenë edhe në harmoni me politikat e BE-së për zhvillim rajonal.

Themelimi i mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik mund të adreson një çështje të cilën Kosova më herët nuk e ka trajtuar sa i përket zhvillimit socio-ekonomik rajonal, bazuar në dokumentet analitike që i përgatit MZHR në koordinim me ministrinë e linjës dhe institucionet relevante adreson propozimet për Qeverinë të cilat japin orientim për një zhvillim të balancuar, bazuar në të dhënat faktike të cilat marrin një pelqim paraprak nga mekanizmi i caktuar ndërinstitucional.

Siç është cekur më lart orientimi strategjik i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është në përputhje edhe me konceptin e OECD-së (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) për zhvillim rajonal.

Si rrjedhojë, Strategjia për Zhvillim Rajonal përmes aktiviteteve të propozuara, synon të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal, aktualisht realizon politikat dhe programet duke marrë parasysh ndarjen rajonale në pesë (5) rajone zhvillimore: Rajoni Zhvillimor Qendër, Lindje, Perëndim, Jug dhe Veri. Operimi i MZHR-së me pesë (5) rajone zhvillimore, vazhdon të bëhet derisa të vendoset ndryshe qoftë me miratimin e Hartës Zonale të Kosovës nga Kuvendi i Kosovës, apo një vendimi për numrin e rajoneve të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. HYRJE

Zhvillimi i balancuar rajonal si politikë konsiderohet si në baza ekonomike, sociale poashtu edhe politike. Politika e zhvillimit të balancuar rajonal ndërhyr për të korrigjuar pabarazitë mes rajoneve të ndryshme të një vendi dhe gjithashtu për ngritjen e standardit të jetesës në një nivel më të lartë me një normë të barabartë.

Strategjia për Zhvillim Rajonal pasqyron sfidat, problemet dhe ngeçjet në Kosovë në fushën e zhvillimit rajonal që duhen adresuar me qëllim të nxitjes së zhvillimit të barabartë zhvillimor dhe përafrimit me politikat e zhvillimit rajonal të BE-së. Në këtë kuptim, në strategji janë paraparë një numër i aktiviteteve që duhet të realizohen për adresimin e sfidave dhe ngeçjeve në fushën e zhvillimit rajonal në Kosovë.

Kjo strategji është hartuar në përputhje me shtojcën 21, të Rregullores (QRK) nr. 16/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe

Rregulloren nr. 14/2017, në të cilën theksohet që Ministria e Zhvillimit Rajonal është kompetente për hartimin, zbatimin, dhe koordinimin e politikave për zhvillim rajonal.

Ky dokument ka marr parasysh edhe legjislacionin në fuqi që ka ndërlidhje me zhvillimin rajonal, strategjitë nacionale dhe sektoriale. Ky dokument është zhvilluar duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë: (shkruaj cilat) ndjekur në mënyrë strikte udhëzimin e dhënë në Manualin për Planifikimin, Zhvillimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit.

Strategjia e Zhvillimit Rajonal ndërlidhet me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2024, me shtyllën e Ekonomisë së zhvilluar dhe modernizim të shtetit;

–Strategjia e Zhvillimit Rajonal ndërlidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), në aspektin e adresimit të pengesave kryesore për zhvillimin e Kosovës dhe përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror;

- Strategjia për Zhvillim Rajonal ndërlidhet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021, sepse është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilit hartohet buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofroj një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë;

- Ndër të tjera, Strategjia e Zhvillimit Rajonal ndërlidhet me MSA-n, kryesisht me pikën që thekson se “Palët do të përpiqen të identifikojnë masat për të forcuar bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e pabarazive rajonale.

2.1. Ligjet Aktuale

Legjislacioni aktual i cili përfshinë fushën e zhvillimit ekonomik dhe bashkëpunimit ndërkomunal në mungese të ligjit për zhvillim rajonal.

Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal – rregullon bashkëpunimin ndër-komunal midis komunave të Republikës së Kosovës për nevojat e ushtrimit të kompetencave të tyre vetanake dhe të zgjeruara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin në fuqi si dhe Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale të Këshillit të Evropës. Po ashtu rregullohet edhe bashkëpunimi i komunave të Republikës së Kosovës me komuna ose institucione të tjera të qeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës në kuadër të binjakëzimit ose formave të tjera të bashkëpunimit brenda kompetencave vetanake dhe të zgjeruara të komunave. Ky ligj parasheh edhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal, ku dy ose me shume komuna kanë të drejtë të lidhin marrëveshje për qëllimet e tyre të përbashkëta në fushën e shërbimeve publike komunale si dhe atë të zhvillimit lokal.

- Interesit të ndërsjellë lokal

- Kryerjes së një ose më shumë kompetencave vetanake ose të zgjeruara të komunave
- Vullnetit të lirë të komunave për të krijuar bashkëpunim ndër-komunal
- Ndarjës së roleve dhe përgjegjësiave mes komunave dhe bashkimit të burimeve komunale për qëllime bashkëpunimi
- Përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të kostos së shërbimeve komunale për qytetarët

Rregullorja për nxitjen e bashkëpunimit ndër komunal – rregullon nxitjen dhe përkrahjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Në veçanti, përcakton fushat/kompetencat si dhe kriteret për bashkëpunim përfshirë: Zhvillimin socio-ekonomik lokal dhe rajonal, zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës, planifikimi urban dhe rural, mbrojtja e mjedisit, promovimi dhe zhvillimi i turizmit, promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, zhvillimi i infrastrukturës ndër-komunale, si dhe çështje tjera që janë në kompetencë vetanake të komunave.

Rregullorja për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – përcakton formën dhe procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtarë në mes të institucioneve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës me komunat dhe institucionet tjera të vetëqeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës. Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje bashkëpunimi të karakterit administrativ dhe teknik edhe me institucione tjera të qeverisjes lokale jashtë vendit. Bashkëpunimi ndërkombëtar mundë të lidhet në disa fusha si në zhvillim ekonomik, planifikim urban dhe rural, zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës, mbrojtjen e mjedisit lokal, ndërtimin dhe kontrollin sipas standardeve, ofrimin e arsimit publik, parashkollor, fillor dhe të mesëm, shëndetësinë publike, banimin publik, zhvillimin e infrastrukturës, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe shume çështje tjera që janë në kompetencë të komunave me legjislacion të zbatueshëm në Kosovë.

Megjithatë, shumica e komunave në Kosovë ende nuk kanë kapacitete për të krijuar një mjedis efektiv për zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës për të gjitha komunitetet.

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale - përcakton fuqinë e plotë të autoriteteve lokale për sa i përket interesave lokale. Ky ligji po ashtu përcakton kompetenca të qarta sa i përket organizimit dhe funksionimit të organeve komunale, financimit të komunave, marrëdhënieve brenda komunave, bashkëpunimit ndër komunal dhe ndërkufitar si dhe marrëdhënieve ndërmjet komunave dhe nivelit qendror. Ligji për vetëqeverisje lokale liston fushat në të cilat autoritetet lokale kanë kompetenca ekskluzive dhe këto ushtrohen në përputhje me standardet e përcaktuara në ligjin në fuqi. Sipas këtij ligji, komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe krijojnë partneritete me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda fushës së kompetencave të tyre për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët. Po ashtu, komunat kanë të drejtë të lidhin edhe marrëveshje bashkëpunimi me organe të huaja të vetëqeverisjes lokale.

Ligji nr. 05/L-079 për Investime strategjike ne Republikën e Kosovës

Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin,

zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike. Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj, për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe të kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në sektorët si: Energji me infrastrukturë dhe miniera, Transport dhe telekomunikacion, Turizëm, Industri përpunuese, Bujqësi dhe industri ushqimore, Shëndetësi, Parqe industriale dhe teknologjike, Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave.

Ligji nr. 02/L-33 për Investimet e Huaja

Qëllimi kryesor i këtij ligji është nxitja dhe inkurajimi i investimeve të huaja në Kosovë duke iu ofruar investitorëve të huaj të drejta dhe garancinë themelore dhe të ekzekutueshme që u japin siguri investitorëve të huaj që ata dhe investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë si dhe në pajtim të plotë me parimin e sundimit të ligjit dhe standardet dhe praktikat e pranura ndërkombëtare. Me nxitjen dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë, ky ligj synon që të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë, veçanërisht zhvillimin e një sektori privat të fuqishëm, konkurrues dhe të angazhuar në degë të ndryshme të ekonomisë.

Ligji nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike

Ky ligj ka për qëllim themelimin e zonave ekonomike, zonave ekonomike të lira, krijimin e bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vend ndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e shfrytëzimit të zonave ekonomike, promovimin e zonave ekonomike, hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike dhe formimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike. Me këtë ligj përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, përdoruesve/operatorëve dhe të subjekteve të tjerë që ushtrojnë aktivitete në lidhje me zona ekonomike, llojin e veprimtarive që kryhen brenda zonave ekonomike, mënyrën e lëvizjes së mallrave nëpër to, dhe lehtësirat fiskale të parashikuara në kuadër të tyre. Krijimi i zonave ekonomike ka për qëllim: Nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Kosovë duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste. Nxitjen e investimeve private në veprimtaritë prodhuese. Të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë, veçanërisht në sektorin privat. Hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimin e tyre. Krijimin e kushteve për biznese për qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit. Rritjen e konkurrencës në biznesin vendor dhe ndërkombëtar. Tërheqjen e teknologjive të përparuara dhe rritjen e konkurueshmërisë së prodhimeve dhe shërbimeve vendore. Përsheptimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kosovar me atë ndërkombëtar, shpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe të kapitalit.

Ligji nr. 04/L-176 për Turizmin

Me këtë ligj përcaktohet baza ligjore dhe korniza institucionale, parimet dhe rregullat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit, vendosja dhe zhvillimi i standardeve të shërbimeve turistike. Fushëveprimi: Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizik dhe juridik, vendor ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në fushën e turizmit në përputhje me standardet e përcaktuara më legjislacionin në fuqi. 3 Parimet e këtij ligji janë: efikasiteti ekonomik, investimi në fushën e turizmit, regjistrimin vullnetar, ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e ambientit, dhe mbrojtja e konsumatorit.

Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillim Rural

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ky ligj përcakton objektivat, masat dhe programin e politikave të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në bazë të Planit për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor. Më këtë ligj përcaktohen dispozitat për ofrimin e shërbimeve publike bujqësore, kërkimit dhe trajnimit profesional, bazën e të dhënave dhe informacionin në fushën e politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural. Me masat për zbatimin e politikës bujqësore dhe të zhvillimit të zonave rurale, synohet të arrihen

Objektivat e përgjithshme të ligjit:

Konkurrenca në prodhimtarinë bujqësore dhe atë rurale, e cila rritë aftësinë e saj konkurruese si për tregun brenda, ashtu edhe për atë jashtë vendit, e cila mundësohet nëpërmjet rritjes së produktivitetit dhe të efikasitetit të veprimtarive ekonomike në zonat rurale;

Rritja e të ardhurave për popullsinë rurale, duke ngritur mirëqenien e saj nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për të gjitha grupet e marginalizuara. Stabiliteti ekonomik, duke garantuar që prodhimi bujqësor të jetë i qëndrueshëm;

Cilësia e prodhimeve të ushqimit duke garantuar që zinxhiri ushqimor është i një cilësie të qëndrueshme dhe i plotëson standardet e përcaktuara;

3. METODOLOGJIA

Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Rajonal është caktuar si një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në Planin e Veprimit ...për Zbatimin e Programit të Qeverisë, planin e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017-2021 si dhe koncept dokumentin për zhvillim rajonal në Kosovë i aprovuar me vendim të Qeverisë nr. 13/61 i datës 22.08.2018. Si hap i parë që është ndërmarrë për hartimin e kësaj strategjie, është formuar Grupi Punues ndërministror, në përbërjen e të cilit kanë qenë përfaqësues institucional, shoqërisë civile, donator, dhe ekspertë të jashtëm.

Gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie, janë realizuar 7 takime, dhe është realizuar procesi i konsultimit paraprak me komunat, ministritë e linjës, ZPS, si dhe shoqërinë civile. Dokumenti, ka kaluar edhe përmes platformës online për konsultime publike. Mbledhja e të dhënave për hartimin e dokumentit, është bërë përmes përgatitjes së analizave paraprake të gjendjes, hulumtimit e dokumenteve tjera strategjike, si dhe komenteve të pranuar gjatë proceseve konsultative.

Për hartimin e kësaj strategjie është themeluar Grupi Punues ndërministror, duke përfshirë institucionet si në vijim:

- Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Ministria e Pushtetit Lokal
- Zyra e Kryeministrit - Zyra për Planifikim Strategjik;
- Zyra e Integritit Evropian/ ZKM;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministria e Ekonomisë dhe Ambijentit;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Ministria e Infrastrukturës;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;

Nga shoqëria civile, pjesë e Grupit Punues kanë qenë:

- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Veri”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Jug”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Qendër”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Lindje”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Perëndim”

4. Analiza e gjendjes aktuale dhe sfidat kryesore:

4.1. Përshkrimi i gjendjes aktuale

Zanafilla e Zhvillimit Rajonal në Kosovë njihet që më herët, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008. Me iniciativë të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe mbështetjes të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) janë nënshkruar pesë marrëveshje ndërkomunale të partneritetit për krijimin e pesë Agjencive për Zhvillimin Rajonal. Këto marrëveshje janë nënshkruar me 16 dhjetor të vitit 2008.

Në vazhdimësi të kësaj, Qeveria e Kosovës në vitin 2009 ka filluar procesin e planifikimit të Programeve për Bashkëpunim Ndërkufitar të financuara nga BE-ja me shtetet fqinj+ (Kosovë–Shqipëri; Kosovë–Maqedoni) dhe një vit më vonë Kosovë–Mali i Zi. Në të gjitha këto programe, rajonet e propozuara për përfshirje si zona të pranueshme në program kanë ndjekur klasifikimin Evropian të rajoneve NUTS III (edhe pse Kosova nuk ka të aplikuar të njëjtin klasifikim). Klasifikim i zonave rajonale statistikore ose

nomenklaturë e njësive territoriale për statistika, është i njohur me shkurtesën NUTS (Nomenclature of Territorial Units for Statistics). Sipas Direktivës së Parlamentit dhe Këshillit Evropian (REGULATION EC No. 1059/2003, Maj 2003) ky klasifikim ka hierarkinë e vet. Sipas kësaj hierarkie ekziston: - niveli qendror NUTS-0; - niveli më i vogël i regjioneve statistikore NUTS-1 dhe NUTS-2; dhe - niveli më i ulët NUTS-3 (që përbëhet prej disa komunave).

Një klasifikim i tillë, ka për qëllim: matjen, pasqyrimin dhe krahasimin e vlerave për indikatorë të ndryshëm zhvillimor socio ekonomik, si dhe ngritjen e fondeve që do të shfrytëzohen si instrumente përcjellëse të politikave të caktuara, me ndikim në përmirësimin dhe balancimin e zhvillimeve nëpër rajonet e klasifikuara statistikore (NUTS). - Numri i popullsisë – është kriteri i vetëm për ndarje rajonale nga rregullorja e BE-së. Si bazë për këtë janë marrë rajonet ekonomike të cilat AZHR-të i përfaqësojnë:

Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Qendër - Rajoni Ekonomik Qendër

Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Lindje – Rajoni Ekonomik Lindje

Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Perëndim – Rajoni Ekonomik Perëndim

Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Jug – Rajoni Ekonomik Jug

Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Veri – Rajoni Ekonomik Veri

Ky model u krijua me qëllim të inicimit të një ndërfaqeje mes palëve të interesit dhe qeverive lokale nëpërmjet krijimit të strukturave operacionale dhe gjithëpërfshirëse të partneritetit për t'i ndihmuar palët e interesit në absorbimin e fondeve dhe granteve të zhvillimit me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë.

Kosova është një nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Në veri dhe lindje ajo kufizohet me Serbinë (352 km), në jug me Maqedoninë (159 km), në perëndim me Shqipërinë (112 km) dhe në veriperëndim më Malin e Zi (79 km). Kosova ka një sipërfaqe prej 10.905,25 km². Popullsia bazë e Republikës së Kosovës sipas “Vlerësimit të popullsisë për vitin 2017” numri i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2017 është vlerësuar gjithsej 1.798.506 banorë rezident numër i cili është marrë si e dhënë bazike për të vlerësuar numrin e popullsisë.

4.2. Analiza e gjendjes sipas rajoneve statistikore të ASK-së dhe sipas rajoneve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

Në vijim, prezantojmë tabelën me të dhëna statistikore sipas 7 rajoneve më të mëdha statistikore të Kosovës : **Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë.**

Tabela e rajoneve statistikore në Kosovë

Zonat rajonale statistikore NUTS-3	Komunat e përfshira	Sip. (në km ²)	% e Sip. pjesëma rrëse	Nr. popullsisë	% e popullsisë pjesëmarrëse
Zona rajonale e Prishtinës	Komuna e Prishtinës – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan, Obiliq dhe Podujevë.	2081	19.0	469.583	26.4
Zona rajonale e Mitrovicës	Komuna e Mitrovicës së Jugut – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Mitrovicë e Veriut., Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan dhe Zubin Potok.	2051	18.8	323.833	13.1
Zona rajonale e Pejës	Komuna e Pejës – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Deçan, Istog dhe Klinë.	1660	15.2	214.254	12.0
Zona rajonale e Prizrenit	Komuna e Prizrenit – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Dragash, Mamushë dhe Suharekë.	1433	13.1	277.007	15.6
Zona rajonale e Ferizajt	Komuna e Ferizajt – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Hani Elezit, Kaçanik, Shtërpçë dhe Shtime	1021	9.4	185.695	10.4
Zona rajonale e Gjilanit	Komuna e Gjilanit – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Kamenicë, Kllokot, Novobërdë, Ranillugë, Partesh dhe Viti.	1413	13.0	188.188	10.6
Zona rajonale e Gjakovës	Komuna e Gjakovës – qendra kryesore rajonale me komunat	1247	11.4	211.461	11.9

	përbërëse: Junik, Malishevë dhe Rahovec.				
--	--	--	--	--	--

4.3. Rajonet zhvillimore sipas grupimit të komunave nga MZHR-së që ka përcjellë logjikën e programeve zhvillimore që BE aktualisht aplikohen: Rajoni Zhvillimor Qendër, Lindje, Perëndim, Jug dhe Veri.

4.3.1. Rajoni zhvillimor Qendër

Rajoni zhvillimor qendër kufizohet me rajonin jug në juglindje, rajonin veri në verilindje me rajonin lindje në juglindje dhe Serbinë në verilindje. **Sipërfaqja e rajonit;** Rajoni zhvillimor qendër përbëhet nga tetë komuna: Prishtina, Podujeva, Lipjani, Obiliqi, Drenasi, Shtime, Fushë Kosova dhe Graçanica. Rajoni zhvillimor qendër ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 2,215.52 km² apo 20.31 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. **Struktura e territorit;** Nga sipërfaqja e përgjithshme, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 87,348.08 hektarë, ndërsa toka e punueshme është 47,663.32 hektarë, kopshte në të gjithë territorin e rajonit qendër janë 237.89 hektarë, toka bujqësore të pa përdorura janë 3,427.71 hektarë. Tokat pyjore përbejnë një total prej 16,801.72 hektarë ndërsa toka jo bujqësore përbejnë një total prej 3,680.09 hektarë. **Popullata e rajonit zhvillimor qendër;** Ky rajon ka një popullsi prej 511,562 banorë apo 28.44 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, dendësia e popullsisë është 230 banorë në një km² dhe gjithsej numri i vendbanimeve është 299 vendbanime në këtë rajon. Kjo tregon për një koncentrim shumë më të madh të popullsisë në rajonin qendër se në zonat tjera kur dihet fakti se rajoni qendër përbën rreth 20.31 % të tërë territorit të Kosovës. **Infrastruktura;** Niveli i infrastrukturës në rajonin zhvillimor qendër është në një nivel me të mirë në krahasim me rajonet tjera. Përqindja e rrugëve lokale të shtruara në këtë rajon i tejkalon mbi 60% ndërsa 70% e vendbanimeve janë të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm. Përqindja e vendbanimeve në sistemin për trajtim të ujërave të zeza është 25%. Në rajonin qendër kalon autostrada Vërmicë-Merdar, që lidh Kosovën me Shqipërinë dhe Serbinë përmes Serbisë me vendet e BE-së, si dhe Autostrada Prishtinë-Shkup që lidh Kosovën me Maqedoninë dhe përmes autostradave të Maqedonisë lidhet me Greqinë dhe Serbinë. Nëpër këtë zonë kalon hekurudha Prishtinë – Fushë Kosovë - Pejë si dhe gjendet Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Ky rajon ka infrastrukturën me të zhvilluar në Kosovë, rrugë lokale të zhvilluara mirë, udhëkryq i autostradave hekurudhave ndërkombëtare dhe në këtë rajon gjendet Aeroporti Ndërkombëtar. **Situata ekonomike;** Profilet e bizneseve me të theksuara në rajonin qendër janë ato të bizneseve individuale duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe ortakëritë e përgjithshme. Sektorët me të zhvilluar janë tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimi, dhe shërbimet. Zonat ekonomike/biznesore në këtë rajon janë: Parku i Biznesit në Drenas i cili është shpall zonë ekonomike me vendim të Qeverisë së Kosovës me datë 18.08.2010. Parku shtrihet në kilometrin e 22-të përgjatë magjistrales Prishtinë – Pejë, në fshatin Koreticë e Epërme. Parku ofron një vend ideal me infrastrukturë fizike dhe shërbime kualitative. Ka një sipërfaqe prej 24 ha i cili ofron lokacione të madhësive të ndryshme për biznese, kryesisht për sektorë të prodhimit dhe shërbimeve. Janë të vendosur rreth 40 biznese. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të

Parkut si dhe ka kyçje individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë, telefoni, internet, etj. Parku Industrial në Qyragë Lipjan është krijuar në vitin 2016, me një sipërfaqe prej 56 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së bashku me komunën e Lipjanit ka filluar investimin në rregullimin e infrastrukturës fizike në këtë zonë ekonomike - faza e parë. Planifikohet që edhe në vitet vijuese MTI të vazhdojë me bashkë investim dhe finalizim të infrastrukturës fizike në mënyrë që të krijojen kushte më të mira për biznese. Ky park industrial është në fazat fillestare të investimeve infrastrukturore dhe ka një numër të vogël të bizneseve në këtë park industrial. Parku Teknologjik në Shtime është krijuar në vitin 2013, me një sipërfaqe prej 10.70 ha. Parku Teknologjik në Shtime gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime-Ferizaj (M-25.3). Parku Teknologjik gjendet afër qytetit, pranë magjistrales, në një udhëkryq në mes të Shkupit - Prishtinës dhe Tiranës. Ky Park teknologjik ka Infrastrukturën fizike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, kanalizim atmosferik, trotuare dhe ndriçim). Në këtë park teknologjik ofrohet lirim nga taksa për leje ndërtimore dhe taksa komunale për aktivitetin afarist, hapësirë në dispozicion varësisht nga kërkesa e bizneseve, janë të vendosura dy biznese të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore dhe tri biznese të tjera në fazën e kontraktimit. Gjithashtu janë edhe Zona Ekonomike në Lipjan afër QMI-së, Zona Ekonomike në Babush. Përpos infrastrukturës në disa zona industriale sfidë mbetet edhe tërheqja e investimeve duke pasqyruar një sërë procedurash për të siguruar një hapësirë në zonat industriale gjë e cila demotivon investitorët potencial. Është e rëndësishme të rishikohen dhe të rivlerësohen politikat, procedurat dhe mbështetja e ofruar për investitorët vendor dhe të huaj duke u bazuar në praktikën më të mirë në rajon. Rajoni zhvillimor qendër e ka numrin më të madh të koncentrimin të bizneseve për arsye se në këtë rajon është kryeqyteti i Kosovës dhe shumica e bizneseve vendore dhe të huaja janë të përqendruara në kryeqendër. Në rajonin zhvillimor qendër janë të regjistruara 68,133 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; biznese individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin qendër me një numër prej 45,626 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 17,667 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 1,822 biznese. **Punësimi;** Rajoni zhvillimor qendër ka potencialin më të madh ekonomik për ofrimin e vendeve të punës, marrë parasysh koncentrimin e institucioneve shtetërore, përfaqësive dhe organizatave të huaja, si dhe përfaqësitë e kompanive biznesore vendore dhe ndërkombëtare. Megjithatë edhe rajoni zhvillimor qendër ballafaqohet me papunësinë. Sipas të dhënave nga Agjensioni i Punësimit, raporti 2017, numri i përgjithshëm i punëkërkuarve në rajonin zhvillimor qendër është 24,457 ndërsa oferta e punës 2,327 pra këtu shihet një raport dhe diferencë e madhe e ofertës dhe kërkesës për punë, edhe pse duhet pasqyruar faktin se këto të dhëna nuk pasqyrojnë realitetin në terren, pjesa më e madhe e fuqisë punëtore nuk drejtohen të zyrat e punësimit për regjistrim. **Norma mesatare e papunësisë;** Sipas Anketës së fuqisë punëtore ka të dhëna për papunësinë sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit, pastaj të dhëna për popullsinë joaktive sipas moshës dhe arsimit, mirëpo këto të dhëna janë vetëm në nivel të përgjithshëm, nuk ka të dhëna për nivelin e papunësisë në nivel lokal dhe rajonal. Mungesa e të dhënave zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikat lokale dhe rajonale për GDP-në të cilat janë tregues esencialë për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve është sfidë e cila duhet të adresohet në të ardhmen.

Sistemi i edukimit; Infrastruktura dhe cilësia e shërbimeve arsimore në rajonin zhvillimor qendër është në nivel mjaft të mirë. Janë ndërtuar dhe riparuar një numër i madh i institucioneve shkollore dhe universitare. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018 numri i shkollave në rajonin zhvillimor qendër në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 244, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 32. Gjithsej shkolla në rajonin zhvillimor qendër të arsimit fillor, të mesëm ulët, dhe të mesëm të lartë janë 276. Sa i përket numrit të shkollave speciale në rajonin zhvillimor qendër sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018 janë 2 shkolla speciale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë qendra të aftësimin profesional (QAP) me 69 punëtori dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komuna. Sipas statistikave për arsimin e lartë bachelor publik në rajonin zhvillimor qendër është një universitet publik në nivelin bachelor ndërsa në nivelin bachelor privat ofrojnë studime 14 kolegje private. **Burimet natyrore;** Rajoni zhvillimor qendër është i pasur me burime natyrore liqeje dhe lumenj. Liqejtë kryesorë artificialë në rajonin zhvillimor qendër janë Liqeni i Batllavës (Podujevë) me madhësi 3.27 km² dhe Liqeni i Badovcit (Prishtinë) 2.57 km². Këta dy liqeje përdoren kryesisht për ujë të pijshëm, por edhe për ujitje. Rajoni zhvillimor qendër është i pasur me resurse minerale, veçanërisht me linjit dhe feronikel, por ka edhe rezerva të plumbit, zinkut, etj. Ekzistimi i resurseve minerale paraqet një mundësi të mirë për zhvillimin e industrisë minerale dhe energjetike. Komuna e Obiliqit njihet të jetë e pasur me resurse natyrore të cilat edhe e bëjnë të jetë zonë e favorshme ekonomike, resurset e mëdha të qymyrit eksploatohen dhe përdoren për prodhimin e energjisë elektrike në termocentralet e Kosovës A dhe B. Në komunën e Podujevës ekziston edhe një miniere e ajo është miniera e Drazhnjës e cila gjendet në fshatin Herticë. Kjo miniere është e pasur me plumb, argjend, ari e zink. Në minierën e nikelit „Çikatovë e Vjetër“ ekzistojnë dy vendburime (trupa mineral): „Dushkaja“ dhe „Suka“. Rezervat gjeologjike në dy minierat (Gllavicë dhe Çikatovë) janë vlerësuar të jenë rreth 13 Mt me përbërje mesatare të nikelit 1.31% dhe të kobaltit 0.06%. **17. Turizmi;** Në rajonin zhvillimor qendër me se shumti janë të zhvilluara turizmi urban dhe kulturor kjo për shkak se në këtë rajon është kryeqyteti dhe tërheqë vizitorë nga vende të ndryshme. Muzeu Etnologjik, kompleksi i banimit “Emin Gjiku” gjendet në bërthamën e vjetër të qytetit të Prishtinës, monumenti i Neë Bornit dhe ideja e ngjyrosjes çdo 17 shkurt, bënë që për çdo vit ky monument të jetë atraksion për turistët, të cilët e vlerësojnë idenë e ndërrimit të ngjyrave të këtij objekti. Muzeu i Kosovës i cili përmban me shumë se 50,000 eksponate të ndryshme është themeluar në vitin 1949-të, ndërsa ndërtesa e tij me stil të arkitekturës austro- hungareze daton që nga viti 1989, Galeria e Arteve të Kosovës. Prishtina ka mbi 30 pika të tjera turistike. Komuna e Podujevës ka hapësira të përshtatshme për turizëm. Liqeni i Batllavës është atraksion për vizitorë. 66 % e territorit të Komunës së Podujevës e përfshijnë malet ku paraqesin një atraksion tjetër për t’u vizituar dhe i përshtatshëm për alpinizëm. Ulpiana është një monument i trashëgimisë kulturore me vlera të mëdha historike në afërsi të Graçanicës, një qytet i themeluar në fillim të shekullit II. Gërmimet arkeologjike kanë dhënë gjurmë të jetës para romake dhe dëshmojnë se Ulpiana është një vazhdimësi e një vendbanimi ilir dhe se kulmin e zhvillimit ekonomik e kulturor ky qytet e kishte arritur në fund të shek. III dhe fillim të shek. IV. Të gjitha këto e bëjnë Ulpianën një nga pikat turistike më të preferuara në Kosovë. Në këtë rajon ka edhe pika të tjera turistike të trashëgimisë kulturore fetare si xhamia dhe kisha të ndryshme.

Potencialet e zhvillimit:

- Marrëdhëniet ekonomike kulturore dhe bashkëpunimi në fusha të ndryshme nxiten nga fakti se Prishtina kryeqyteti i Kosovës i përket këtij rajoni, dhe luan rolin e një qendre administrative, ekonomike dhe kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka potenciale të shumta në krahasim me rajonet e tjera;
- Kryeqytetet janë qendra që zhvillojnë konkurrencë dhe punësim dhe mund të shihen si nxitës të inovacionit dhe rritjes, si dhe qendrat për arsim, shkencë, diversitet social, kulturor dhe etnik, duke ofruar një sërë shërbimesh dhe atraksionesh kulturore në zonën për rreth tyre.
- Ky rajon ofron një mjedis të favorshëm për risitë dhe biznesin për shkak të përqendrimit të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore (tendenca pozitive në aspektin e rritjes së popullsisë) në rajon dhe në kryeqytet në veçanti dhe në disponueshmërinë e profesionistëve të kualifikuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- Zhvillimi i bizneseve, tregtisë dhe turizmit mbështetet nga infrastruktura dhe kushtet e të berit biznes, transporti rrugor hekurudhor rrjeti i rrugëve dhe autostradave kryesore dhe aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës;
- Rajoni zhvillimor qëndër mbetet një nga rajonet më të mëdha dhe më të rëndësishëm në sektorin e ndërtimit të Kosovës meqë llogaritet të ketë numrin më të madh të kompanive aktive në Kosovë, sektorë tjerë me potencial janë sektori i përpunimit të ushqimit, bizneset e TIK, prodhimi i produkteve të tekstilit dhe bujqësia;

Sfidat kryesore

- Fuqizimi i zonave ekonomike, parqeve të biznesit dhe inkubatorëve biznesor, krijimi i infrastrukturës teknike, lehtësimi i procedurave dhe krijimi i një skeme përkrahëse në punësim për bizneset vendore dhe të huaja të cilat do të ishin atraktive për tërheqjen e investimeve strategjike në fushën e prodhimit me qëllim specifik exportin. Momentalisht politikat nuk janë favorizuese për tërheqjen e investimeve në këto zona.
- Gjenerimi i vendeve të reja të punës së qëndrueshme sidomos për të rinjtë dhe të sapo diplomuarit, krijimi i partneritetit me akteret e sektorit publik dhe privat për përkrahjen e programeve të praktikës dhe punësimit të qëndrueshëm.
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e pavarur të Clustereve/Grupimeve biznesore rajonale Clusteret/Grupimet konsiderohen të rrisin produktivitetin me të cilën kompanitë mund të konkurojnë, në nivel kombëtar rajonal dhe global. Clusteret/Grupimet kanë potencial të ndikojnë duke rritur produktivitetin e kompanive në grup, duke nxitur inovacionin në këtë fushë dhe duke stimuluar biznese të reja në këtë fushë.

4.3.2 Rajoni zhvillimor lindje

Sipërfaqja e rajonit përbëhet nga njëmbëdhjetë komuna: Ferizaj, Gjilan, Han i Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Shtërpçë, Viti, Kllokoti, Ranillug dhe Partesh. Mbulon rreth 2.298.50 km² apo 21 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Rajoni zhvillimor lindje ka 293 vendbanime. Ai kufizohet me

rajonin zhvillimor qendër në anën veriore, me Serbinë në lindje, me rajonin zhvillimor jug në anën perëndimore dhe me Maqedoninë në anën jugore. **Popullata e rajonit socio-ekonomik;** është i banuar nga rreth 327,960 banorë apo 18.23 % të popullsisë së përgjithshme. Dendësia në këtë rajon është 142 banorë në një km². **Struktura e territorit;** Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 87,555.12 hektarë, Sipërfaqja e tokës së punueshme në rajonin lindje në total është 34.365,61 hektarë. Sa i përket sipërfaqeve të kopshteve rajoni zhvillimor lindje në total ka 266 hektar kopshte, Sipërfaqja e livadheve dhe kullosave është 51,759.88 hektarë ndërsa tokat pyjore në rajonin lindje përbejnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 12,476,52. **Infrastruktura;** Rrugët ekzistuese në rajonin lindje shtrihen përgjatë linjave të komunikacionit Shqipëri - Kosovë - Serbi - Maqedoni. Infrastruktura në rajonin lindje është përmirësuar dukshëm në vitet e fundit si në rrugët rajonale si dhe në ato lokale . “Rruga 6” e cila përfshinë segmentin Prishtinë – Hani i Elezit, (Arbër Xhaferi) në kufirin me Maqedoninë është e gjatë rreth 65 kilometra dhe është një autostradë me standard evropian e realizuar në periudhën 2015-2019. Kjo autostradë është urë lidhëse e rrjetit kryesor të transportit të Evropës Jug-Lindore. Linja hekurudhore e cila është pjesë e linjës hekurudhore ndërkombëtare përfshin këto qytete të rajonit lindje Ferizajin, Kaçanikun dhe Hanin e Elezit. Përqindja e rrugëve lokale në rajonin zhvillimor lindje i tejkalon 63% rrugë të shtruara, gjithashtu edhe shtrirja e rrjetit të ujësjellësit është në një nivel të mirë dhe e shtrirë në 58% të territorit. **Situata ekonomike;** Zonat ekonomike të themeluara në këtë rajon janë; parku industrial në Viti, Komuna e Vitisë ka filluar iniciative për krijimin e Parkut Industrial në Budrikë e Epërme me sipërfaqe prej 15.5 ha. Është në fazën kompletimit të dokumentacionit sipas legjislacionit për zona ekonomike. Inkubatori I biznesit në Gjilan, zona industrial në Ferizaj. Profilet e bizneseve në rajonin lindje janë të larmishme. Rajoni zhvillimor lindje është rajoni me numrin më të madh të komunave. Në rajonin lindje janë të regjistruara 34109 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; Biznese Individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin lindje me një numër prej 28574 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 4746 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 642 biznes. **Sistemi i edukimit;** Sistemi arsimor në rajonin lindje është i ngjashëm me rajonet e tjera me një infrastrukturë të mirë. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-20182 numri i shkollave në rajonin lindje në arsimin fillorë dhe të mesëm të ulët është 200 ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 27. Gjithsejtë shkolla në rajonin lindje janë 227 shkolla në arsimin publik. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë qendra të aftësimin profesional (QAP) me 69 punëtori dhe 30 profesione të ndryshme. Në këtë rajon janë dy universitete publike dhe një universitet privat. **Punësimi;** Resurset e reja njerëzore në rajonin lindje paraqesin një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Sfidat ekonomike me të cilën ballafaqohet ky rajon është papunësia. Fenomeni i papunësisë më së shumti është i shfaqur tek të rinjtë. Kërkesa e përgjithshme për punë në masë të madhe e tejkalon mundësitë që ofrohen nga tregu i punës. Pra konsiderohet se mundësitë për punësim janë të limituara sidomos tek të rinjtë pas diplomimit. Sipas të dhënave nga agjencia e punësimit, raporti 2017 numri i përgjithshëm i punëpunë kërkuarve në rajonin lindje është 20.905 punë kërkuar, ndërsa oferta e punës 1831. pra këtu shihet një raport dhe diferencë e madhe e ofertës dhe kërkesës për punë, edhe pse duhet pasqyruar faktin se

² <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-ne-es/statistikat-e-arsimit-20172018>

këto të dhëna nuk pasqyrojnë realitetin në terren sepse pjesa më e madhe e fuqisë punëtore nuk drejtohen të zyrat e punësimit për regjistrim. **Norma mesatare e papunësisë;** Sipas Anketës së fuqisë punëtore ka të dhëna për papunësinë sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit, pastaj të dhëna për popullsinë joaktive sipas moshës dhe arsimit, mirëpo këto të dhëna janë vetëm në nivel të përgjithshëm, nuk ka të dhëna për nivelin e papunësinë në nivel lokal dhe rajonal. Mungesa e të dhënave zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikave lokale dhe rajonale për GDP-në të cilat janë tregues esenciale për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve është sfidë e cila duhet të adresohet në të ardhmen. **Burimet natyrore;** Burimet natyrore paraqesin një faktor mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, Rajoni zhvillimor lindje posedon liqene dhe lumenj përmes të cilëve mund të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike. Ky rajon karakterizohet me kapacitet të kënaqshëm të ujit dhe burimeve të tjera natyrore. Lumenjtë më të mëdhenj në Rajon janë: Lepenci, Nerodime dhe Morava e Binçës. Gjithashtu ky rajon është i pasur edhe me minerale dhe xehe si: plumbi, zinku, argjendi, ari, bakri, kromi, hekuri, magnezi, linjiti, guri dekorativ, mermeri, kaolini, graniti, rërë kuarci, argjilë. Në këtë rajon dallohet miniera Artanës që ka përqindje të lartë të këtyre mineraleve dhe xeheve. Vendburimi më i rëndësishëm Mn, sipas të dhënave të kompleksit Trepça gjendet në zonën e minierës ekzistuese të Artanës ku përmes tjetërsimit të Pb-Zn është formuar mineralizimi i Mn-Fe. Resurset e vlerësuara të manganit në këtë vendburim janë rreth 5 milionë ton xehe, me përmbajtje rreth 22 % Mn. Valorizimi i xehes së Mn nga ky lokacion duhet të paraprihet me shqyrtimet teknike të gjendjes dhe mundësive të qasjes në minierën e mbyllur të Mn, si dhe kërkimet programore të mundësisë dhe efekteve të koncentrimit të Mn nga xehja në koncentrat, me metoda të flotacionit dhe me metoda të koncentrimit magnetik. **Turizmi;**

Potencialet e zhvillimit:

- Lokacioni i favorshëm, mjedisi natyror i mirëmbajtur, trashëgimia kulturore dhe historike mundësojnë zhvillimin e turizmit dhe rritjen e potencialit për industrinë turistike. Turizmi dimëror, turizmi rural, turizmi malor janë potenciale të cilat kanë nevojë për fuqizim në këtë rajon. Turizmi dimëror e bënë këtë rajon mjaft konkurrues edhe në nivel ndërkombëtar, Brezovica me pozitën e saj gjeografike qëndron në një pikë strategjike ku distanca mund të arrihet për një orë me makinë nga dy aeroporte ndërkombëtare: Aeroporti i Prishtinës (60 km) dhe ai i Shkupit (70 km) ;
- Agrikultura, përpunimi i prodhimeve bujqësore janë disa nga potencialet e këtij rajoni stimulimi i politikave për nxitjen e shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe krijimin e kushteve për biznese në fushën e përpunimit dhe prodhimit të ushqimit;
- Cilësia e mjedisit dhe e natyrës së pastër e bëjnë këtë rajon më tërheqës për qëllime rezidenciale, afariste apo turistike;
- Rajoni do të përfitojë nga “Rruga 6” e cila përfshinë segmentin Prishtinë – Hani i Elezit, (Arbën Xhaferi) në kufirin me Maqedoninë, është e gjatë rreth 65 kilometra dhe është një autostradë me standard evropian e realizuar në periudhën 2015-2019. Kjo autostradë është urë lidhëse e rrjetit kryesor të transportit të Evropës Jug-Lindore dhe Evropës Perëndimore;

- Ka potencial për bashkëpunim ndërkufitar, ndër-rajonal dhe trans-nacional, për shkak të vendndodhjes strategjike dhe kyçe të rajonit përgjatë rrugëve të korridoreve të transportit tokësor dhe hekurudhor i cili lidhet me autostradat e Evropës Juglindore dhe sistemi hekurudhor me Greqinë dhe portin e Selanikut;

Sfidat kryesore

- Ngritja e kapaciteteve për shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Mungesa e të dhënave zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikave lokale dhe rajonale për GDP-në të cilat janë tregues esenciale për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve;
- Ngritja e infrastrukturës për biznese të reja dhe ngritja e kapaciteteve të bizneseve ekzistuese në fushën e prodhimit dhe përpunimit në zonat rurale e cila do të rezultonte me ngritjen e nivelit të punësimit në këto zona;
- Krijimi i për zhvillimin e pavarur të Clustereve/Grupimeve biznesore rajonale Clusteret/Grupimet konsiderohen të rrisin produktivitetin me të cilën kompanitë mund të konkurrojnë, në nivel kombëtar rajonal dhe global. Clusteret/Grupimet kanë potencial të ndikojnë duke rritur produktivitetin e kompanive në grup, duke nxitur inovacionin në këtë fushë dhe duke stimuluar biznese të reja në këtë fushë.

Në vazhden e kalsifikimit si zone stasistikore sipas kriterëve të NUTS-3, zona Lindjes i ka dy qendra të mëdha rajonale stasistikore, apo thënë ndryshe Zona rajonale e Ferizajt

-Komuna e Ferizajt – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Hani Elezit, Kaçanik, Shtërpçë dhe Shtime. Sip në (km 2)-1021- % e Sip. Pjesëmarrëse 9.4- Nr. popullsisë 185.695 - % e popullsisë pjesëmarrëse 10.4.

-Zona rajonale e Gjilanit

Komuna e Gjilanit – qendra kryesore rajonale me komunat përbërëse: Kamenicë, Kllokot, Novobërdë, Ranillugë, Partesh dhe Viti. Sip në (km 2)-1413- % e Sip. Pjesëmarrëse 13.0- Nr. popullsisë 188.188- % e popullsisë pjesëmarrëse 10.4.

4.3.3 Rajoni zhvillimor perëndim

Sipërfaqja e rajonit përbëhet nga gjashtë komuna: Istog, Klinë, Pejë, Junik, Deçan dhe Gjakovë me gjithsej 314 vendbanime të përfshira në rajon. Me një sipërfaqe të përgjithshme prej 2,324.38 km² ky rajon mbulon rreth 21.31 % të sipërfaqes së Kosovës. Kufizohet me Malin e zi në veriperëndim, ndërsa në jug perëndim kufizohet me Shqipërinë, në pjesën verilindore me rajonin ekonomik veri, dhe juglindje me rajonin ekonomik jug. Rajoni Perëndimor është i mbuluar kryesisht nga Rrafshi i Dukagjinit që kufizohet nga malet e larta të Alpeve Shqiptare. **Popullata e rajonit socio-ekonomik**; ky rajon është i banuar nga rreth 323,588 banorë apo 17.99 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Dendësia e popullsisë është 139 banorë në një km² **Struktura e territorit**; Rajoni perëndimor i Kosovës vlerësohet të ketë rreth 89346.75 hektarë tokë bujqësore në gjashtë komunat e saj toke e punueshme rreth 37376.21 hektarë , 12729.67 hektarë pyje, livadhe dhe kulloza 50434, ndërsa toka jo bujqësore 3294.75. **Situata ekonomike**;

Zonat ekonomike te themeluara ne ketë rajon janë; ‘‘Zona Ekonomike Amerikane’’ në Gjakovë me një sipërfaqe prej 500 hektarë toke dhe është ne fazat fillestare, nuk ka akoma biznese të themeluara në këtë zonë dhe Parku industrial në Gjakovë. Në rajonin veri janë të regjistruara 17626 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; Biznese Individuale, kompani te huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme , shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin veri me një numër prej 15432 biznese duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 1732 biznese dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 332 biznese. **Punësimi**; Resurset njerëzore dhe tregu i punës në rajonin perëndim paraqesin gjithashtu një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike .Në rajonin perëndim kemi një numër prej 17500 punëkërkuesve dhe një ofertë tregu prej 1520 vendeve të lira të punës bazuar kjo në statistikat e nxjerra nga raporti i punësimit për vitin 2017. Raporti mes ofertës dhe kërkesës ka një diferencë mjaft të madhe për shkak të problematikës së mungesës së qasjes dhe regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit dhe mungesës së të dhënave për papunësinë në nivel lokal. **Norma mesatare e papunësisë**; Sipas Anketës së fuqisë punëtore ka të dhëna për papunësinë sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit, pastaj të dhëna për popullsinë joaktive sipas moshës dhe arsimit, mirëpo këto të dhëna janë vetëm në nivel të përgjithshëm, nuk ka të dhëna për nivelin e papunësisë në nivel lokal dhe rajonal. Mungesa e të dhënave zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikat lokale dhe rajonale për GDP-në të cilat janë tregues esenciale për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve është sfida e cila duhet të adresohet në të ardhmen. **Sistemi i edukimit** Sistemi arsimor publik dhe privat ne rajonin perëndimor është në katër nivele, Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë, niveli Bachelor dhe Master. Duke u bazuar ne statistikat e arsimit publik 2017-20183 në rajonin perëndim janë gjithsejtë 187 shkolla. 164 shkolla përfaqësojnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, dhe 23 shkolla në arsimin e mesëm të lartë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë qendra të aftësimi profesional (QAP) me 69 punëtori dhe 30 profesione të ndryshme, në këto qendra bëhet aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit nëpër komuna. Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht rajonin perëndim ofrohen studime në Bachelor dhe Master në institucione publike dhe private. Sipas statistikave të arsimit publik 2017-2018 janë dy universitete publike, dhe dy kolegje private. **Infrastruktura**; Infrastruktura në rajonin perëndimor të Republikës së Kosovës është relativisht e zhvilluar. Ky rajon është pikë lidhëse e Kosovës duke u kufizuar me Shqipërinë (Gjakova dhe Juniku), me Malin e Zi (Deçani dhe Peja), dhe me Serbinë (Komuna e Istogut). Vitet e fundit është investuar shumë në rrugët lokale, ujësjellës, kanalizim, sistemin energjetik dhe ndriçim publik. Sistemi energjetik mbulon pothuajse tërë territorin e rajonit perëndimor. Infrastruktura lokale në rajonin zhvillimor perëndim është e mire mbi 60% e rrugëve lokale janë të shtruara dhe afër 80% e vendbanimeve kanë qasje ne sistemin e ujit të pijshëm. **Burimet Natyrore**; Rajoni zhvillimor perëndimor është i pasur me burime natyrore ky ka një numër të konsiderueshëm të liqeneve si; liqeni i Radoniqit dhe Erenikut në Komunën e Gjakovës, dy liqenet natyrore të Gjeravicës në Junik, liqeni i Liqenatit dhe liqeni i Drelajve

³ <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-arsimit-20172018>

në komunën Pejë si dhe “Liqeni i pafund” “Liqeni leqe leqe” dhe Liqeni i Gjorvices në Deçan. Pasuritë e tjera ujore të këtij rajoni janë numri i madh i lumenjve si: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, lumi Klina, lumi Mirusha, lumi i Istogut, lumi i Erenikut, lumi i Lloqanit etj. Përveç kësaj, ka edhe rezerva të linjtit në komunën e Istogut, me një sipërfaqe prej 100 km² dhe me një trashësi prej 30-50 metrash deri në 230 metra thellësi. Ndërsa Komuna Klinës ka resurse natyrore minerale dhe jo minerale si: rezerva të linjtit 2 miliardë ton, të xeheve së boksitit 2 milionë ton. **Turizmi;** Rajoni zhvillimor perëndimor ka turizmin si një nga fushat me potencial për zhvillim dhe gjenerim të vendeve të reja të punës në rajonin perëndimor të Kosovës. Degët e turizmit të identifikuar janë turizmi malor me elemente sportive dhe rekreative, kryesisht në Pejë, Deçan, Junik, Gjakovë dhe Istog. Turizmi eksplorues i shpellave (speleologji) është i zhvilluar në Pejë, Gjakovë Deçan dhe Klinë; turizmi shëndetësor dhe i mirëqenies duke filluar nga ujërat termo-minerale në Istog dhe vende të tjera të përshtatshme për zhvillimin e qendrave të rehabilitimit në të gjithë rajonin; ujin, tokën, malin dhe sportet ajrore dhe aktivitetet rekreative për të cilat rajoni perëndimor ofron kushtet më të përshtatshme; agro-turizmi në vende me peizazhe të pasura dhe jetë aktive rurale; dhe gjithashtu ajo me një rëndësi të veçantë, turizmi kulturor dhe trashëgimia. Pavarësisht nga ky potencial për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimit të shërbimeve të mikpritjes së duhur, të cilat do të mbështesin dhe pasurojnë ofertën turistike, ajo që është arritur deri tani është ende larg realizimit të potencialit të plotë të këtij sektori.

Potencialet e zhvillimit

- Rajoni zhvillimor perëndimor është një ndër rajonet me potencialet më të mëdha në fushën e turizmit, potencialet turistike të këtij rajoni përfshijnë terrenet malore që mbulojnë parkun kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna, gjithashtu trashëgimia kulturore është një element i rëndësishëm për tërheqjen e vizitoreve në këtë rajon;
- Ka potencial për bashkëpunim ndërkufitar, ndër-rajonal dhe trans-nacional, për shkak të vendndodhjes strategjike dhe kyçe të rajonit përgjatë rrugëve të korridoreve të transportit tokësor dhe lidhjen me transportin detar përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi, kufijtë e këtij rajoni me dy shtete infrastrukturore të transportit rajonal dhe lokal të zhvilluar mirë;
- Infrastruktura sociale dhe teknike lehtësisht e qasshme dhe përqendrimi i shkollave të mesme dhe të larta profesionale paraqesin disa mundësi për ekonominë e rajonit;

Sfidat kryesore

- Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e turizmit në zonat malore të cilat përfshijnë territoret që mbulojnë Parqet Kombëtare, ngritja e kapaciteteve për shfrytëzimin e kapaciteteve të turizmit rural dhe agroturizmit;
- Ngritja e kapaciteteve të NVM-ve në fushën e shërbimeve hoteliere, turistike, përpunimit të produkteve agro-industriale dhe përpunimit të ushqimit;
- Tërheqja e investimeve dhe investimeve strategjike në zonat e themeluara industriale, dhe përkrahja e bizneseve të themeluara në këto zona;
- Përkrahja e grupeve të marginalizuara në zonat rurale, krijimi i një infrastrukture më të mirë për bizneset në fushën e prodhimit dhe të përpunimit të produkteve agro-industriale dhe përpunimit të produkteve në zonat rurale me qëllim të stimulimit të punësimit në këto zona;

- Punësimi i të rinjve pas diplomimit, krijimi i kushteve për punë praktike dhe punë të qëndrueshme;
- Krijimi për zhvillimin e pavarur të Clustereve/Grupimeve biznesore rajonale Clusteret/Grupimet konsiderohen të rrisin produktivitetin me të cilën kompanitë mund të konkurrojnë, në nivel kombëtar rajonal dhe global. Clusteret/Grupimet kanë potencial të ndikojnë duke rritur produktivitetin e kompanive në grup, duke nxitur inovacionin në këtë fushë dhe duke stimuluar biznese të reja në këtë fushë.

4.3.4 Rajoni zhvillimor jug

Sipërfaqja e rajonit; Rajoni zhvillimor jug përbëhet nga gjashtë komuna: Rahoveci, Malisheva, Prizreni, Suhareka, Dragashi dhe Mamusha. Rajoni jug shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Kufizohet me Shqipërinë në jugperëndim, Maqedoninë në juglindje, në lindje me rajonin zhvillimor lindje, në verilindje rajonin ekonomik qendër, në pjesën veriperëndimore kufizohet me rajonin ekonomik perëndim. Ky rajon ka 239 vendbanime në territorin e tij. Rajoni zhvillimor jug ka 2,015.01 km² apo 18.47 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. **Popullata e rajonit zhvillimor jug;** është rajoni i dytë për nga numri i popullsisë në Kosovë, ky rajon ka 409,449 banorë apo 22.76 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Dendësia është 203 banorë në një km². **Struktura e territorit;** Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 95,108.77 hektarë, toka të punueshme dhe ara janë 31,396.26 hektarë, kopshte 209.07 hektarë tokë bujqësore e pa përdorur 5214.34 hektarë, toka pyjore 13380.39, toka jo bujqësore 2973.91 hektarë. Vreshtaria është tipike për këtë rajon dhe meriton kujdes të veçantë. Ky sektor dominon në Rahovec, por gjithashtu shtrihet në komunat e Suharekës dhe Prizrenit. Kushtet e përshtatshme agroklmatike krijojnë potencial të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm të kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës. Gjithashtu edhe perimtaria dhe pemëtaria kanë potenciale për zhvillim dhe kultivohen në masë të madhe në këtë rajon. **Infrastruktura;** Rajoni zhvillimor jug karakterizohet si rajoni me një nga rrjetet më të zhvilluara të rrugëve lokale, rajonale dhe magjistrale. Në rajonin jug kalon autostrada Prishtinë-Tiranë e cila është një autostradë me standarde evropiane. Autostrada lidh Kosovën dhe shtetet e rajonit dhe me portin e Durrësit, është një linjë strategjike për zhvillimin e transportit detar me atë rrugor, një segment mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Rajoni zhvillimor jug ka të organizuar mjaft mirë infrastrukturën lokale mbi 75% e rrugëve lokale janë të shtruara dhe të rregulluara në këtë rajon. 61.94 % e vendbanimeve në këtë rajon kanë qasje në sistemin e ujit të pijshëm. Ndërsa përqindja e vendbanimeve që kanë qasje në sistemin e trajtimit të ujerave të zeza është mjaft e ulët. **Situata ekonomike;** Në rajonin zhvillimor jug, janë themeluar disa zona industriale të cilat synojnë të tërheqin investitor dhe biznese në fushën e prodhimit dhe përpunimit. Zonat Ekonomike në rajonin zhvillimor jug janë; Zona industriale në Suharekë gjendet në Shirokë të Suharekës, e cila në lindje është e kufizuar me rrugën ekzistuese Suharekë - Prizren, në jug me rrugën ekzistuese të zonës së vjetër industriale, në perëndim me vreshtat ekzistuese dhe në veri me brezin e gjelbërimit. Veprimtaritë që parashihen të vendosen në zonën industriale janë: Përpunimi i produkteve ushqimore, Përpunimi i prodhimeve nga tekstili dhe lëkura, përpunimi i elementeve nga materiali i aluminit, plastikes dhe drurit, Përpunimi nga qelqi, guri, mermerin dhe hekuri elemente nga betoni, përpunimi i elementeve/teknikes nga elektrikë dhe elektroteknika, etj. Zona tjetër në këtë komunë është Zona Agro - Industriale në Suharekë, është krijuar

në vitin 2015 me sipërfaqe prej 28 ha. Zona Agro-industriale gjendet në fshatin Samadraxhë – Suharekë. Kane filluar investimet në këtë zonë ekonomike, fillimisht në energji elektrike dhe ujësjellës. Në zonën ekonomike respektivisht " Zona Agro - Industriale " aktualisht janë nënshkruar tri (3) kontrata si dhe me pesë (5) përfitues të tjerë janë në fazën e nënshkrimit të kontratave. Edhe gjatë këtij viti është duke u vazhduar me investime në infrastrukturë fizike. Komuna e Suharekës pronën që e jep në shfrytëzim afatgjatë në Zona Agro - Industriale në Samadraxhë për bizneset ka planifikuar lehtësira. Komuna e Dragashit edhe pse një komunë e vogël posedon një zonë ekonomike në Mejdan të fshatit Shajmë. Në rajonin jug janë të regjistruara 23710 biznese, ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; Biznese Individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme , shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin jug me një numër prej 20,500 biznese duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 2076 biznese dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 390 biznese.

Punësimi; Bazuar në raportin e punësimit për vitin 2017 mund të themi se rajoni zhvillimor jug ka një numër prej 18,037 të punëkërkuesve dhe një ofertë prej 1588 vendeve të lira të punës ku shihet përsëri një diferencë e madhe mes kërkesës dhe ofertës për shkak të problematikes së mungesës së qasjes dhe regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit dhe mungesës se të dhënave për papunësinë në nivel lokal.

Norma mesatare e papunësisë; Sipas Anketës së fuqisë punëtore ka të dhëna për papunësinë sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit, pastaj të dhëna për popullsinë joaktive sipas moshës dhe arsimit, mirëpo këto të dhëna janë vetëm në nivel të përgjithshëm, nuk ka të dhëna për nivelin e papunësinë në nivel lokal dhe rajonal. Mungesa e të dhënave zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikat lokale dhe rajonale për GDP-në të cilat janë tregues esenciale për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve është sfide e cila duhet të adresohet në të ardhmen.

Sistemi i edukimit; Sipas statistikave të arsimit publik në rajonin jug të vitit 2017-2018 numri i shkollave në arsimin fillor, mesëm të ulët është 42 ndërsa në arsimin e mesëm të lartë 28 shkolla gjithsejtë shkolla në rajonin jug në të dy nivelet janë 70 shkolla. Në institucionet e arsimit të lartë publik ofrohen studime të nivelit Bachelor dhe Master në një universitet publik.

Burimet natyrore; Rajoni zhvillimor jug ka përqindje të madhe të tokës me cilësi të mirë, kushte të favorshme klimatike, të cilat në kombinim me mundësitë e përparimit të mëtejshëm të ujitjes, e bëjnë rajonin të përshtatshëm për zhvillimin e integruar të bujqësisë. Ujërat në rajonin jug duke përfshirë lumenjtë dhe liqenet janë burime të çmueshme të këtij rajoni, shumica e lumenjve derdhen në lumin Drini i Bardhë, i cili rrjedh në një gjatësi prej 122 kilometrash në pjesën perëndimore të rajonit. Liqejë të vegjël natyror në këtë rajon janë Liqeni i Livadices, Liqeni i Jazhinces, Liqeni i Dragaqines. Ky rajon është i njohur për gurët gëlqeror, gurët gëlqerorë paraqiten në ato të kuq dhe murrmë, gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorëve mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³. Minerale si Kobalti, Nikeli dhe Bakri gjenden në rrethinën e Gurit të Kuq ku është konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikeli-Kobaltit. Minerali i Kromit mendohet që gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e përroit Rimnik.

Turizmi; Rajoni zhvillimor jug ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Pozita specifike, gjeografike, pasuritë natyrore, shembuj të shumtë të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe folklori i

larmishëm, e bëjnë rajonin jug një vend ideal për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Ekziston një potencial i madh për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit malor dhe kampimit gjatë fundjavave. Zhvillimi i turizmit duke përfshirë turizmin rural mund të bëhet një burim i rëndësishëm i mirëqenies për një pjesë të popullsisë në rritje të rajonit. Ky rajon ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Komuna e Prizrenit është një xhevahir i turizmit që përbën edhe njërin nga fushat e zhvillimit të komunës së Prizrenit. Prizreni është një ndër qytetet strategjike turistike për vizitorë të huaj dhe vendor. Malet e Sharrit përmbajnë qindra metra të zonave të cilat nuk shfrytëzohen plotësisht dhe paraqesin potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror. Malet e Koretnikut dhe të Pashtrikut kanë potenciale të mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit malor, si alpinizmi dhe gjuetia, sikurse dhe lumenjtë e shumë në rajon që ofrojnë mundësinë e zhvillimit të sporteve ujore dhe të peshkimit. Festivalet dhe organizimet e ndryshme kulturore dhe artistike dhe panaire agro-biznesi janë tipike për këtë rajon dhe tërheqin shumë vizitorë vendor dhe të huaj.

Potencialet e zhvillimit:

- Rajoni zhvillimor ka potenciale të mëdha në fushën e turizmit të trashëgimisë kulturore, turizmit rural dhe turizmit malor. Ky rajon njihet për organizimet të festivaleve të ndryshme kulturore artistike dhe panaire të ndryshme agro-biznesi. Turizmi kontribuon drejt rritjes dhe zhvillimit të plotë të këtij rajoni duke sjellë vlera dhe përfitime të shumta ekonomike dhe duke ndihmuar në ndërtimin e imazhit dhe identitetit dhe brendeve të këtij rajoni.
- Agro-kulturat dhe vreshtaria janë sektor tipik të rajonit, zhvillimi i agro-industriave konkurruese është vendimtar për gjenerimin e punësimit dhe mundësitë e të ardhurave. Agro-industritë kanë potencial për të ofruar punësim për popullsinë rurale jo vetëm në bujqësi, por edhe jashtë fermave aktivitetet të tilla si trajtimi, paketimi, përpunimi, transportimi dhe marketingun e ushqimit dhe produkteve bujqësore;
- Infrastruktura e mirë rrugore dhe autostrada Vermicë-Merdare e cila kalon në këtë rajon krijon potenciale të zhvillimit në fushën e transportit dhe shërbimeve gjithashtu është lehtësim për ndërmarrjet e këtij rajoni, ky rajon do të përfitoj nga kjo autostradë duke pasqyruar që autostrada lidhet me portin e Durrësit dhe ndikon në tërheqjen e investimeve prodhuese për export.

Sfidat kryesore

- Krijimi i mekanizmave dhe përkrahja e tyre për analiza socio-ekonomike rajonale në fushën e punësimit dhe GDP-së rajonale, krijimi i politikave dhe mekanizmave për nxitjen e punësimit në zonat e marginalizuara.
- Ngritja e kapaciteteve të NVM-ve në fushën turizmit, ndërmarrjeve për promovim të rajonit, bizneseve hoteliere, transportuese dhe shërbyese, krijimi i skemave për udhërrëfyes të certifikuar.
- Ngritja e kapaciteteve të NVM-ve në fushën agro-industriave e prodhimit dhe përpunimit të produkteve agro-industriale, tërheqja e investimeve në zonën Agro-Industriale në Suhareke, dhe zonat e tjera ekonomike.
- Përkrahja e grupeve të marginalizuara në zonat e thella krijimi i mundësive të punësimit përmes skemave të granteve dhe krijimi i bizneseve të reja të qëndrueshme.

- Krijimi për zhvillimin e pavarur të Clustereve/Grupimeve biznesore rajonale Clusteret/Grupimet konsiderohen të rrisin produktivitetin me të cilën kompanitë mund të konkurrojnë, në nivel kombëtar rajonal dhe global. Clusteret/Grupimet kanë potencial të ndikojnë duke rritur produktivitetin e kompanive në grup, duke nxitur inovacionin në këtë fushë dhe duke stimuluar biznese të reja në këtë fushë.

4.3.5 Rajoni zhvillimor veri

Sipërfaqja e rajonit; Rajoni zhvillimor veri është i përbërë nga shtatë komuna: Mitrovica jugut, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtrri, Skenderaj. Rajoni Veri ka 2,051.84 km² apo 18.81% të territorit të Republikës së Kosovës. Rajoni zhvillimor veri kufizohet me Serbinë në veri, me rajonin zhvillimor qendër në verilindje me rajonin zhvillimor perëndim në perëndim. Rajoni i veriut ka 361 vendbanime. **Popullata e rajonit socio-ekonomik;** Rajoni zhvillimor veri ka 225,938 banorë apo 12.56% të popullsisë së përgjithshme të Republikës së Kosovës. Dendësia e popullsisë është 110 banorë në një km². **Struktura e territorit;** Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 48,148.73 hektarë (Mungon sipërfaqja e komunave Mitrovicë e veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok). Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regjionin e Shalës janë: turizmi malor, turizmi kulturor, turizmi rural dhe eko-turizmi. Në rajonin zhvillimor veri janë themeluar disa zona industriale; Parku i biznesit në Mitrovicën jugore me një sipërfaqe prej 3.5 hektar, Parku industrial në Frashër-Mitrovicë me një sipërfaqe prej 48 hektarë, Parku i biznesit në Dolane në komunën e Zveçanit, parku i biznesit në Vushtrri. **Infrastruktura;** Kur flasim për rajonin veri mund të themi se infrastruktura rrugore rajonale dhe ajo lokale janë në një nivel mesatar zhvillimor në krahasim me rajonet tjera edhe pse investimet në infrastrukturë në përgjithësi janë në rritje e sipër. Magjistralla në këtë rajon kalon në perëndim të qytetit, përgjatë lumit Ibër dhe Liqenit të Gazivodës deri në Malin e Zi dhe në Detin Adriatik, ndërsa autostrada Prishtinë- Mitrovicë është në ndërtim e sipër. Sa i përket infrastrukturës së rrugëve lokale rajoni zhvillimor veri qëndron në një përqindje të mirë të zhvillimit, bazuar kjo në statistikat e performancës të viti 2017, në statistika ka mungese të dhënave për komunat në veri të territorit. **Punësimi;** Rajoni zhvillimor veri ka potencial të mjaftueshëm për ofrimin e fuqisë punëtore, papunësia është një element ekzistues dhe i shpërfaqur në këtë rajon. Në bazë të statistikave të raportit të punësimit për vitin 2017 numri i përgjithshëm i punëkërkuessve në rajonin veri është 13950 ndërsa oferta e punës është 1138 ku dhe shohim një diferencë të madhe ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë, gjithmonë duke pas parasysh që të dhënat nuk e pasqyrojnë realitetin në terren. **Norma mesatare e papunësisë;** Sipas Anketës së fuqisë punëtore ka të dhëna për papunësinë sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit, pastaj të dhëna për popullsinë joaktive sipas moshës dhe arsimimit, mirëpo këto të dhëna janë vetëm në nivel të përgjithshëm, nuk ka të dhëna për nivelin e papunësinë në nivel lokal dhe rajonal. Mungesa e të dhënave zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikat lokale dhe rajonale për GDP-në të cilat janë tregues esenciale për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve është sfidë e cila duhet të adresohet në të ardhmen. **Sistemi i edukimit;** Sistemi arsimor në këtë rajon është i organizuar në bazë të linjave etnike. Shkollat në Mitrovicën jugore, Vushtrri, Skenderaj janë nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës dhe shkollat në komunat e Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit dhe

në Mitrovicën e veriut funksionojnë si sistem paralel. Sipas statistikave të arsimit publik te vitit 2017-2018 4 në rajonin veri, gjithsejtë janë 141 shkolla në të dy nivelet e arsimit fillor i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Ne nivelin e arsimit fillore dhe te mesëm te ulët në rajonin veri i kemi 126 shkolla ndërsa në arsimin e mesëm te lartë 12 shkolla. **Situata ekonomike;** Rajoni zhvillimor i veriut është i njohur për minierat dhe industrinë metalurgjike duke qenë punëdhënësi kryesor në rajon. Mitrovica është e pasur me minerale në veçanti me linjit, metale si plumb, zink, ferronikel, magnezium , etj. Gjendja e tanishme teknologjike e këtyre xeheroreve, tani për tani, nuk lejon eksploatimin efektiv të xeheve, ndërsa kapacitetet e ndërtuara përpunuese, po ashtu, kanë një degjenerim teknologjik. Eksploatimi i këtyre xeheve varet nga interesi i investitorëve strategjikë. Janë mbi 17626 biznese te regjistruara në këtë rajon, numri me i madh i bizneseve te regjistruara është ne fushën e biznesit individual pastaj bizneset me përgjegjësi te kufizuar dhe ortakëritë e përgjithshme. Parqet operative të biznesit në rajon janë si vijon: Parku i Biznesit në Mitrovicë, është krijuar në vitin 2012, më sipërfaqe prej 3.5 ha. Parku i Biznesit ishte iniciativa e parë në Kosovë nga Komuna e Mitrovicës e përkrahur nga MTI-së e cilësuar si pilot projekt për një zonë biznesi për prodhues. Implementimi i saj ishte model për thithjen e donacioneve dhe inkurajim për biznese. Për këtë qëllim Komuna ka ndarë 3.5 hektar tokë me qëllim të implementimit të projektit “ Parku i Biznesit “, nga i cili kanë përfutuar gjithsej 22 biznese. Parku i biznesit në Dolane komuna e Zveqanit, Parku i biznesit në Vushtri. Parku i biznesit në Skenderaj nuk është funksionalizuar dhe ne vitin 2018 është marrë iniciative e re për zhvendosjen dhe funksionalizimin e tij. Parku Industrial në Frashër-Mitrovicë, është krijuar në vitin 2014 me sipërfaqe prej 48 ha. Është investuar në rregullimin infrastrukturës fizike, prej tyre 10 ha janë rrafshuar dhe rregulluar për shpallje, janë nënshkruar 7 kontrata për të filluar investimet dhe nga ato 7 aplikime, një investitor veçse ka filluar investimin. Në Parkun Industrial në Frashër është zhvilluar në faza e I, II, III & e IV , kurse tani është duke u punuar në fazën e V-të. **Burimet natyrore;** Ky rajon ka resurse minerale nëntokësore, toka pyjore, toka pjellore, burime te pasura me ujë dhe potencial turistik. Rajoni zhvillimor i veriut është shumë i pasur më burime ujore duke theksuar këtu lumenjtë, Ibër dhe Sitnicë dhe liqeni më i madh artificial i Ujmanit në Zubin Potok një nga rezervuarët më të mëdha të ujit të këtij lloji në Evropë. Miniera Trepça ka një infrastrukturë të mirë sipas modelit bashkëkohor të minierave nëntokësore, i ka tri puse servili dhe të ajrosjes, është e zhvilluar në 12 horizonte, kurse ndërmjet tri horizonteve të fundit janë zhvilluar rampat që mundësojnë aplikimin e mekanizimit bashkëkohor në përgatitje dhe në shfrytëzim të xeheve. Miniera me infrastrukturën e vetë si dhe me metodat bashkëkohore të mbushjes, ka kapacitetin e shfrytëzimit të xeheve prej 500.000 deri në 650.000 ton xehe në vit. Miniera e Stantërgut me vendburimet që e rrethojnë, ka rezerva prej rreth 35 Mt, ose shprehur përmes sasisë të metaleve në xehe, 1,349,579 ton plumb, 1,080,504 ton zink dhe 2,280,224 kg argjend, dhe aktualisht paraqet një nga potencialet më të rëndësishme të xeheve sulfite të Pb dhe Zn në regjion.⁵ **Turizmi;** Rajoni zhvillimor i veriut ka potenciale për zhvillimin e turizmit. Malet e larta si Mokra, Gora, Shala e Bajgores, Çyçavica me natyrën e tyre të bukur paraqesin potencial të madh për zhvillimin e eko-turizmit dhe turizmit dimëror. Lugina e Ibrit mund të përdoret për rekreacione të ndryshme dhe aktivitete sportive. Liqeni i Ujmanit është tërheqëse për vizitorët gjatë

⁴ <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-arsimit-20172018>

⁵ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Minerare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf fq 22

periudhës së verës. Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në regjionin e Shalës janë: turizmi malor, turizmi kulturor, turizmi rural dhe eko-turizmi. Turizmi malor-bjeshkët e Bajgores. Një lloj potenciali turistik që ka Shala , janë minierat e dala jashtë funksionit në Trepçë , të cilat janë pika interesante për zhvillimin e turizmit. Muzeu i kristaleve është i themeluar në vitin 1964 në të cilin janë të vendosura mbi 1300 eksponentë të llojeve të ndryshëm të kristaleve duke e shndërruar muzeun në një objekt me rendësi të madhe kombëtare për Kosovën si në aspekt të vlerave po ashtu edhe në aspektin turistik. Vushtrria është një ndër qytetet më të lashta të Kosovës, e cila në periudhën romake përmendet si qendër tregtare me emrin Vicianum. Ne Komunën e Skenderajt janë kullat historike komplekset memoriale dhe atraksione turistike te cilat vizitohen nga shume turistë vendas dhe të huaj.

Potencialet e zhvillimit

- Ky rajon është i pasur me resurse minerale nëntokësore, ka potenciale të mëdha në shfrytëzimin e burimeve natyrore minerare, miniera Trepça ka një infrastrukturë të mirë sipas modelit të minierave nëntokësore .
- Rajoni zhvillimor i veriut ka potenciale për zhvillimin e turizmit rural dhe malor, me malet e larta si Mokra, Gora, Shala e Bajgores, Çyçavica, gjithashtu dhe liqeni i Ujmanit është një pikë atraktive për zhvillimin e turizmit. Vushtrria është një ndër qytetet më të lashta të Kosovës me mjaft pika turistike, gjithashtu edhe Skenderaj ka potenciale për turizëm.

Sfidat kryesore

- Fuqizimi i zonave ekonomike, përmirësimi i infrastrukturës, krijimi i infrastrukturës në zonat ekonomike dhe industriale tërheqja e investimeve dhe investimeve strategjike në zonat e themeluara industriale, përkrahja e bizneseve të themeluara në këto zona, lehtësimi i procedurave dhe krijimi i një skeme përkrahëse në punësim për bizneset vendore dhe te huaja .
- Zhvillimi i modelit sektorial të prodhimit, rritja e eksportit dhe rritja e të ardhurave dhe punësimi. Krijimi i Clustereve/Grupimeve biznesore rajonale Clusteret/Grupimet konsiderohen të rrisin produktivitetin me të cilën kompanitë mund të konkurrojnë, në nivel kombëtar rajonal dhe global. Clusteret/Grupimet kane potencial të ndikojnë duke rritur produktivitetin e kompanive në grup, duke nxitur inovacionin në këtë fushë dhe duke stimuluar biznese të reja në këtë fushë.

4.4. Paraqitja e problemit dhe faktorët nxitës

Definimi i problemit: Kosova aktualisht ka mungesë të infrastrukturës ligjore dhe politika për zhvillim rajonal. Andaj, si faktorët nxitës për hartimin e dokumentit “Startegjia për Zhvillim Rajonal” janë:

1. Mungesa e sistemit për matjen e përfomancës rajonale sipas rajoneve zhvillimore;
2. Mungesë të politikave zhvillimore për të nxitë konkurrencë më të madhe në rajon;
3. Mos ndërlidhja në mes të politikave sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në rajone zhvillimore;
4. Qasje e kufizuar në programe të bashkëpunimit rajonal;

5. Mos klasifikimi i Kosovës sipas rajoneve statistikore NUTS;

6. Mungesë të mekanizmave të nevojshme për bashkërendimin të zhvillimit rajonal.

4.5 Praktikrat e Vendeve të Rajonit

Shqipëria – Në rastin e Shqipërisë, duke u bazuar në analizën institucionale të këtij shteti kanë qenë një varg arsyesh që i ka shtyrë për të ndërmarrë hapa në hartimin e një strategjie për zhvillim rajonal në radhë të parë ka qenë:

- Migrimi i brendshëm i cili ka rezultuar me pabarazi të brendshme masive.
- Stimulimi i një rritje të qëndrueshme dhe të ekuilibruar në aspektin social-ekonomike ndërmjet rajoneve të Shqipërisë, në përgjithësi, dhe zonave malore dhe periferike, në veçanti, me qëllim që të mbështetet një zhvillim i shpejtë i të gjithë vendit dhe të përshpejtohen proceset e integritimit dhe ngritjen e kohezionit socio ekonomik në vend.

Përveç dokumentit strategjik dhe objektivave të hartuara, institucionet e Shqipërisë, duhet pasur parasysh se për të promovuar zhvillimin e balancuar rajonal, përveç strategjisë të ndarë në objektiva, avancimin e këtyre politikave e kanë synuar dhe e synojnë nëpërmjet nxjerrjes së Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe akteve nënligjore përkatëse dhe nëpërmjet zhvillimit të strukturave të nevojshme institucionale për të menaxhuar politikrat rajonale. Koncepti i “marrëveshjes për zhvillimin e qarkut”: një plan i pranuar financiar, operacional dhe strategjik shumë-vjeçar i cili parashton mbështetjen e qeverisë qendrore për prioritetet e zhvillimit në secilin prej qarqeve ka qenë njëri nga hapat e ndërmarrë nga institucionet.

Instrumenti i dytë i Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal (SNZHR), synon reduktimin e pabarazive ndërmjet zonave jo të favorizuara dhe mesatares së Shqipërisë duke lehtësuar (mundësuar) aktoret kombëtare, rajonale dhe lokale për të bërë përpjekje bashkëpunimi për të rritur potencialin e zhvillimit të këtyre zonave.

Elementet kryesore apo karakteristikat të këtij programi janë;

Një bazë e standardizuar për përcaktimin e disavantazheve rajonale nëpërmjet përdorimit të

një modeli të pranuar të nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të tyre;

- Përcaktimi i zonave jo të favorizuara për një periudhë 5 vjeçare;
- Një plan qeveritar për zhvillimin e zonave jo të favorizuara dhe alokimi i një linje të veçante buxhetore.

Me vendimin VKM Nr. 438, datë 18.7.2018 ka kaluar funksionet Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe agjencive të zhvillimit rajonal (AZHR) të Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është organizatë zhvillimore që i përgjigjet sfidave dhe partnerëve të saj në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. FSHZH është një institucion që u krijua me misionin për

zbutjen e varfërisë në vendet rurale, zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar.

Kroacia – Politika e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Kroacisë sikurse shumica e vendeve dërmuese në aspektin e synimit apo si objektiv të përgjithshëm të politikës së zhvillimit rajonal është të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kroacisë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke krijuar kushte që do të mundësojnë konkurrencën në të gjitha pjesët e vendit dhe realizimin e potencialeve të tyre të zhvillimit “.

Për të arritur këtë qëllim përmes politikës së zhvillimit, angazhimet institucionale i kanë orientuar veçanërisht duke u përpjekur për të siguruar lidhjen mes institucioneve lokale dhe rajonale duke i ndërlidhur me prioritetet e zhvillimit të nivelit qendror dhe qëllimeve të politikës së kohezionit të Bashkimi Evropian, me theks të veçante mbështetje për zonat më pak të zhvilluara për rritje dhe shërbim sa më optimal. Një element domethënës në politikën e zhvillimit rajonal, Kroacia i kushton masave për zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale me theks të veçant në zonat kufitare; inkurajimin e bashkëpunimit territorial dhe shfrytëzimin efikas të fondeve. Strategjia për Zhvillim Rajonal e Republikës së Kroacisë mbështetet në tre elemente:

1. Rritja e cilësisë së jetës duke nxitur zhvillimin e suksesshëm të territorit duke përfshirë sinergjinë e aspekteve të ndryshme të shoqërisë, zhvillimin hapësinor dhe mjedisor, duke bashkuar nga njëra anë masat që lidhen me përmirësimin e kapaciteteve rajonale dhe lokale të zhvillimit dhe ngritjen e nivelit të njohurive dhe aftësive për të përmirësuar cilësinë e jetës , masa për të siguruar dhe përmirësuar infrastrukturën bazë lokale dhe rajonale. Objektivi gjithashtu lejon vazhdimin e zbatimit të politikave specifike për zhvillimin e zonave të asistuara si dhe zonat me karakteristika zhvillimore të cilat nuk janë domosdoshmërisht të pazhvilluara por janë specifike për zhvillim.

2. Zhvillimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë rajonale dhe punësimi, duke mbështetur zhvillimin e ekonomisë rajonale dhe lokale, duke përmirësuar infrastrukturën ekonomike, duke krijuar një mjedis stimulues biznesi dhe forcimin e burimeve njerëzore, dhe duke nxitur edukimin lidhur me nevojat e ekonomisë në nivel rajonal dhe lokal.

3. Përmbajtja e sistemit të zhvillimit rregullator, përmban aspekte të ndryshme të menaxhimit të zhvillimit rajonal që kanë për qëllim sigurimin e mjedisit të përshtatshëm institucional dhe mbështetjen e zhvillimit të fushave përkatëse tematike. Qëllimi është të rregullojë procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të politikave zhvillimore në të gjitha nivelet e qeverisjes, pastaj të harmonizojë politikat dhe ligjet publike në nivel kombëtar dhe rajonal në të gjithë sektorët dhe forcimin e kapaciteteve financiare dhe administrative të palëve të interesuara në nivel lokal dhe rajonal.

Objektivat janë shumëdimensionale, integrale dhe respektojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Për secilën nga objektivat strategjike janë përcaktuar prioritetet, të cilat pastaj përpunohen në një numër masash të përshtatshme të zhvillimit rajonal.

Maqedonia – Edhe në rastin e Maqedonisë nevoja për planifikimin e zhvillimit rajonal në vend është imponuar kryesisht për shkak të pabarazive të mëdha në mes të qendrës Shkupit dhe pjesëve të tjera të

vendit. Kjo situatë ka kontribuar shumë në mungese të gjatë të një politike të zhvillimit rajonal që rezultoi në një model të zhvillimit mono-centric ku qendrat për karakteristikat e tyre ekonomike dhe të tjera sociale të ndara në thelb nga vende të tjera të banuara në vend. Për më tepër, procesi i afrimit me Bashkimin Evropian ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes në mesin e institucioneve relevante në lidhje me rëndësinë e planifikimit të zhvillimit rajonal, si parakusht për të reduktuar pabarazitë në mes të rajoneve të cilat do të lejojnë më shpejtë të plotësojnë kriteret ekonomike për anëtarësim në BE.

Parimet bazë mbi të cilat bazohet politika e zhvillimit rajonal në Maqedoni janë:

- 1. Parimi i programimit** – ndërtimi i një sistemi shumëvjeçar të programimit dhe zbatimi i një politike të zhvillimit rajonal që përfshin identifikimin e prioriteteve dhe masave të politikave, financimin, menaxhimin dhe kontrollin e tyre;
- 2. Parimi i partneritetit** – bashkëpunim në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, partnerët ekonomikë dhe socialë dhe përfaqësues të tjerë relevantë të shoqërisë civile;
- 3. Parimi i harmonizimit** – qëllimet, prioritetet dhe masat në dokumentet planifikuese për zhvillimin rajonal duhet të jenë në përputhje me objektivat, prioritetet dhe masat në dokumentet strategjike zhvillimore në nivel dhe të programit të dokumenteve kombëtare për integrimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian;
- 4. Parimi i bashkëfinancimit** – Masat e politikës së bashkë-financimit për të promovuar zhvillimin e balancuar rajonal të buxhetit, buxhetet e qeverive lokale, fondet e BE-së dhe burime të tjera ndërkombëtare, si dhe fonde nga persona juridikë vendas dhe të huaj dhe individët;
- 5. Parimi i transparencës** – informimi i rregullt, në kohë dhe objektiv i publikut për masat e politikës për nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal, si dhe sigurimi i qasjes së lirë në informacionin e palëve të interesuara;
- 6. Parimi i subsidiaritetit** – përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe aktiviteteve për zhvillimin rajonal të kryera dhe të planifikuara nga rajonet dhe njësitë e qeverisjes vendore, nëse nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre, ose jo nën juridiksionin e organeve shtetërore dhe
- 7. Parimi i qëndrueshmërisë** – respektimi i komponentëve ekonomik, socialë dhe mjedisorë të zhvillimit në krijimin e një politike për nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal.

Bullgaria – Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal e Bullgarisë për periudhën 2012-2022 është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të politikës së qeverisë për arritjen e një zhvillimi të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të rajoneve të vendit dhe për tejkalimin e dallimeve apo pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të politikës gjithë-evropiane të kohezionit social dhe ekonomik.

Ky dokument strategjik përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjata të politikës së zhvillimit rajonal, i cili është integral, mundëson koordinimin e politikave sektoriale në territorin përkatës dhe mbështet sinkronizmin apo ndërveprimin midis tyre.

Sikurse në shumicën e vendeve që e promovojnë këtë politikë publike edhe shteti bullgar përmes kësaj politike, po edhe përmes legjislacionit në fuqi synon në arritjen e qëllimeve të politikës së zhvillimit rajonal, përkatësisht përmes zvogëlimit të pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në shtrirjen e zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor; mandej sigurimi i kushteve për rritje ekonomike të përshpejtuar dhe një nivel të lartë të punësimit, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit territorial. Përveç aspektit strukturore dhe objektivave, Bullgaria ka realizuar një analizë shumë të thukët të rajoneve të shtetit Bullgar, dhe mbi bazën e vlerësimit të resurseve, potencialeve ekonomike kanë arritur të theksojnë prioritetet territoriale, të rajoneve të ndryshme, të cilat i kanë grupuar në këto elemente.

- Mbështetje për një zhvillim territorial policentrik dhe të balancuar;
- Promovimi i zhvillimit të integruar në zonat urbane, rurale dhe specifike;
- Integrimi territorial në rajone funksionale ndërkufitare dhe transnacional;
- Sigurimi i konkurrencës së rajoneve në tregun global nëpërmjet ekonomive të forta vendore;
- Përmirësimi i lidhjes territoriale ndërmjet individëve, komuniteteve dhe bizneseve;
- Menaxhimi dhe lidhja e aseteve mjedisore, peizazhore dhe kulturore të rajoneve

4.6 Zhvillimi i politikave përmes adresimit të problemit

